

# Bashkia Has

## Pjesëmarrja politike dhe qytetare e të rinjve

---

RAPORT VLERËSIMI

2024

# Bashkia Has

## Pjesëmarrja politike dhe qytetare e të rinjve

---

RAPORT VLERËSIMI

2024

**Autor:**  
Jonida Naska

**Kontribuesit:**  
Alisa Peçi  
Blerina Hamzallari  
Liliana Brati  
Arbërie Rada

© Center for Bridging Communities, Qershori, 2024

*Center for Bridging Communities, CBC është një organizatë jo fitimprurëse që ka si qëllim kryesor të kontribuojë në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm duke fuqizuar komunitetin; të mbrojë të drejtat e grupeve të marginalizuara; të promovojë dhe ndërmarrë iniciativa që nxitin përfshirjen, integrimin social dhe dialogun ndërkulturore.*

Publikimi i këtij reporti është mbështetur nga Fondacioni "Konrad Adenauer" Tiranë. Gjetjet, opinionet, përfundimet dhe rekandimit e shprehura në këtë raport janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit "Konrad Adenauer".



# Tabela e përbajtjes

|  |    |
|--|----|
| Lista e tabelave dhe figurave.....                                     | 4  |
| Përbledhje.....  | 6  |
| Metodologjia.....  | 8  |
| Vështrim mbi treguesit e angazhimit qytetar publik.....                | 10 |
| 1. Të dhëna sociale dhe demografike të Bashkisë HAS .....              | 18 |
| 2. Buxhetimi për rinninë.....  | 17 |
| 3. Gjetjet kryesore të angazhimit politik të të rinxve .....           | 21 |
| 3.1 Analizë e angazhimit politik konvencional dhe jokonvencional ..... | 21 |
| 3.2 Besimi i të rinxve në politikëbërjen lokale.....                   | 28 |
| 4. Gjetjet kryesore të angazhimit qytetar të të rinxve.....            | 34 |
| 4.1 Problematikat dhe sfidat lokale.....                               | 34 |
| 4.2 Analizë e angazhimit qytetar.....                                  | 36 |
| Përfundime .....   | 41 |
| Bibliografia.....  | 43 |

## **Lista e tabelave**

|  |    |
|--|----|
| Tabela I: Treguesit e angazhimit qytetar .....                                   | 11 |
| Tabela ii: Pjesëmarrja qytetare e publikut .....                                 | 12 |
| Tabela III. Të dhënat demografike të Bashkisë Has. ....                          | 16 |
| Tabela IV: Burimet e financimit për vitet 2021-2023 në Lekë (mijë lekë).....     | 17 |
| Tabela V: Shpërndarja e buxhetit sipas programeve, 2023 në Lekë (mijë lekë)..... | 18 |

## **Lista e figurave**

|   |    |
|---|----|
| Figura I: Harta e Bashkisë Has, sipas Ministrisë së Çështjeve Vendore ..... | 15 |
| Figura II: Paraqitura e programeve në buxhet .....                          | 19 |
| Figura III: Forma të angazhimit politik konvencional të të rindje .....     | 24 |
| Figura IV: Forma të angazhimit politik jokonvencional të të rindje .....    | 27 |
| Figura V : Interesi i të rindje mbi politikëbërjen në nivel lokal .....     | 30 |
| Figura VI: Problematika komunitare në Bashkinë Has .....                    | 34 |
| Figura VII: Forma të angazhimit qytetar të të rindje .....                  | 37 |

*"Fuqizimi, zhvillimi dhe angazhimi i tē rijnve është një mënyrë për tē ndërtuar një botë më të mirë. OKB-ja nuk mund ta arrijë misionin e saj pa partneritetin me tē rijnjtë, duke u siguruar që ata jo vetëm tē dëgjohen, por tē kuptohen, jo vetëm tē angazhohen, por tē fuqizohen dhe jo vetëm duke u mbështetur, por edhe duke udhëhequr përpjekjet dhe proceset globale".*

*United Nations Youth Strategy, "Youth 2030"*

# Përbledhje

Në Republikën e Shqipërisë, në nivel kombëtar janë hartuar strategji dhe plane veprimi për përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve. Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 e vë theksin tek angazhimi qytetar dhe politik i të rinjve, nëpërmjet përfshirjes së tyre në çështjet komunitare dhe proceset vendimmarrëse.

Studime të ndryshme tregojnë se për pjesën më të madhe të të rinjve angazhimi politik dhe qytetar fillon në nivel lokal, ku ata adoptojnë praktika, norma dhe mundësi pozitive për të ardhmen e tyre, duke u përfshirë në një demokraci në shkallë të ulët.

*Qëllimi i raportit është të analizojë pjesëmarrjen e të rinjve, bazuar në treguesit kryesorë të angazhimit politik dhe qytetar. Ky raport sjell një sërë rekomandimesh mbi përmirësimin e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset lokale vendimmarrëse dhe ndërmarrjen e iniciativave qytetare në Bashkinë Has.*

Në hartimin e raportit janë përdorur metoda të kombinuara, cilësore dhe sasiore. Treguesit e pjesëmarrjes janë vlerësuar sipas tre kategorive kryesore: *treguesit qytetarë, treguesit e pjesëmarrjes në procesin zgjedhor* dhe *treguesit e aktivitetit politik*.

Analiza e të dhënave mbi angazhimin politik konvencional evidentoi se pjesëmarrja e të rinjve në proceset politike dhe vendimmarrëse si votimi, anëtarësimi në një parti politike, kandidimi për zgjedhje politike dhe përfshirja në fushata zgjedhore është e ulët. Gjithashtu u konstatua një interes i ulët i të rinjve mbi përfshirjen në proceset e vendimmarrjes politike lokale. Nivele shumë të ulëta të angazhimit politik jokonvencional u gjetën për të rinjtë e grupmoshës 15-29 vjeç, të cilët nuk ishin angazhuar në asnjë formë të pjesëmarrjes politike jokonvencionale si: protesta, demonstrata, marshime, nënshkrim të peticioneve, shkrimi i letrave, e-maileve për politikanë ose zyrtarë të lartë etj.

Treguesit e angazhimit qytetar mbi përfshirjen në iniciativa në komunitet, si pjesë e shërbimit komunitar të bazuar në shkollë, shënuan përqindjen më të lartë, shoqëruar nga treguesit mbi mirëqenien e të tjerëve në komunitet dhe donacionet për bamirësi, duke treguar për nivele të larta të kohezionit social nëpërmjet nismave individuale dhe kolektive të të rinxve.

Rekomandimet kryesore mbi angazhimin politik lidhen me rritjen e ndërgjegjësimit të të rinxve mbi të drejtën e votës përmes programeve të lidershipit, edukimit ligjor, edukimit në vazhdim dhe fushatave ndërgjegjësuese. Të rinxjtë kanë besim të ulët në politikëbërje, ndaj edukimi politik është një mjet i rëndësishëm në të mësuarit mbi demokracinë si sistem politik dhe proceset e vendimmarrjes. Promovimi i një mjedisi mundësues që përfshin kuadrin ligjor, politikat rimore dhe planet e veprimit për rininë, ka rëndësi për të siguruar pjesëmarrjen e të rinxve në një gamë të gjerë procesesh zgjedhore dhe në qeverisjen lokale.

Pjesëmarrja e të rinxve në proceset vendimmarrëse dhe në nisma qytetare kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm dhe endogjen të komuniteteve lokale. Angazhimi gjithëpërfshirës i të rinxve, kur kryhet në bashkëpunim me vendimmarrësit, mund të ndikojë në rezultatet e politikave dhe të frenojë tokenizmin politik dhe qytetar, ndaj është e rëndësishme të promovohen modele konsultative të pjesëmarrjes së të rinxve. Promovimi i modeleve konsultative të pjesëmarrjes së të rinxve në diskutimet publike përpara vendimmarrjes do të përmirësonë legjitimitetin e vendimeve politike. Përfshirja e të rinxve në debatet publike duhet të shoqërohet me rritjen e transparencës dhe të informimit mbi iniciativat lokale, programet rimore dhe buxhetet e dedikuara për rininë.

Ky raport nëpërmjet rekomandimeve sjell një kontribut në shërbim të avancimit të ndërhyrjeve ekzistuese të ndërmarra nga Bashkia Has, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022 -2029.

# Metodologja

Në hartimin e këtij raporti mbi analizën e pjesëmarrjes politike dhe të angazhimit qytetar të të rindjeve në Bashkinë e Hasit janë përdorur metoda të kombinuara, cilësore dhe sasiore.

## Metoda e kërkimit sasior

Në përbushje të qëllimit të këtij raporti është realizuar një *anketim*, me instrument metodologjik një pyetësor, i cili përbëhet nga të dhëna: a) socio-demografike b) të angazhimit politik të të rindjeve c) të angazhimit qytetar të të rindjeve.

Janë plotësuar në mënyrë rastësore pyetësorë me 105 të rinj të grupmoshës 15-17 vjeç dhe të grupmoshës 18-29 vjeç, për të vlerësuar perceptimet mbi sjelljen politike, angazhimin qytetar dhe problematikat kryesore në nivel lokal. Pyetësorët u shpërndanë në qytetin e Krumës dhe në Njësitë Administrative të Bashkisë së Hasit, në periudhën Mars 2024-Prill 2024, për të matur perceptimin mbi çështjet e lartpërmendura jo vetëm të të rindjeve të qytetit por edhe të zonave rurale.

## Metodat e kërkimit cilësor

Për të krijuar një tablo të përgjithshme në nivel politikash dhe të dhënash janë shqyrtuar kuadri ligjor, strategjitet rimore në nivel qendror dhe vendor, raportet e institucioneve ndërkombëtare dhe kombëtare mbi pjesëmarrjen politike dhe qytetare të të rindjeve. Janë shqyrtuar dokumentet përkatëse me qëllim eksplorimin e koncepteve bazë, mekanizmave ligjorë dhe pjesëmarrjen e të rindjeve në vendimmarrje.

Janë kryer *dy fokus grupe* me 10 të rinj për të marrë informacion mbi sfidat dhe nevojat e të rinjve për angazhimin e tyre si qytetarë aktivë. Fokus grupet ndihmuat për të hulumtuar më tej mbi arsyet e përfshirjes së të rinjve në jetën komunitare, politike dhe publike. Gjithashtu, përveç mbledhjes së informacionit gjatë fokus grupeve, u shkëmbyen ide dhe u dhanë sugjerime mbi përmirësimin e pjesëmarrjes si qytetare dhe politike të të rinjve.

Një tjetër metodë e përdorur janë *intervistat* me punonjës të Bashkisë Has dhe anëtarë të Këshillit Vendor të Rinisë (KVR-së). Bashkia Has është një bashki e vogël dhe numri i punonjësve që mbulon çështjet rimore është i ulët, ndërkohë KVR është duke u riorganizuar pas zgjedhjeve lokale të vitit 2023 dhe ndryshimit të drejtimit të qeverisjes lokale. Nëpërmjet intervistave u analizuan nga pikëpamja cilësore se cilat janë kapacitetet dhe sfidat e stafit të Bashkisë Has dhe Këshillit Vendor Rinor në punën me të rinjtë.

Ky raport vlerësimi do të shërbejë si një dokument burimor të dhënash të pjesëmarrjes politike dhe qytetare të të rinjve në Bashkinë Has. Përfundimet dhe rekomandimet e këtij reporti janë bazuar në të dhënat dhe gjetjet e evidentuara nga zbatimi i metodave të mësipërme.

# Vështrim mbi treguesit e angazhimit qytetar dhe politik

Pjesëmarrja politike dhe qytetare është një prej elementëve më të rëndësishëm të shoqërive demokratike. Koncepti i aktivizmit politik rinor në proceset politike është zhvilluar në kuadër të disiplinave të ndryshme sociologjike dhe psikologjike si: Funksionalizmi strukturor (T. Parsons, R. Merton dhe të tjerë); Biheviorizmi (G. Laswell dhe Ch. Mariam); Qasja sistemike (G. Almond, N. Luman, K. Doich); Institucionalizmi dhe neoinstitucionalizmi (P. Hall, R. Taylor dhe të tjerë); dhe Konfliktualiteti (R. Darendorf, L. Kozer e të tjerë). Teoricienët modernë reflektoan se si proceset e modernizimit të shoqërisë ndikojnë edhe në format e pjesëmarrjes politike të të rindjeve (R. Inglehart, G. O'Donnell, R. Dahl, J. Habermas)<sup>1</sup>. Sociologu Roger Hart zhvilloi modelin e shkallës së pjesëmarrjes së të rindjeve, sipas të cilët vendimmarra e përbashkët e të rindjeve dhe të rriturve është forma kryesore e pjesëmarrjes, e ndjekur nga shkalla ku të rindjetë iniciojnë dhe drejtojnë vendimmarjen.

Studiuesit Keeter, Zukin, Andolina, dhe Jenkins krijuan një listë me **aktivitete kryesore** që ata i konsideron si përbërës të angazhimit qytetar. **Angazhimi qytetar** i referohet mënyrave në të cilat qytetarët marrin pjesë në jetën e një komuniteti, për të përmirësuar kushtet për të tjerët ose pér të ndihmuar në formësimin e së ardhmes së komunitetit<sup>2</sup>. Treguesit e angazhimit qytetar janë paraqitur në tabelën I, si më poshtë.

<sup>1</sup> Galstyan, Marina, "Youth Political Participation", fq.4. Linku: [https://pjp-eu.coe.int/documents/42128013/47262631>Youth-Political-participation\\_Lit+review\\_BRIEF\\_FINAL.pdf](https://pjp-eu.coe.int/documents/42128013/47262631>Youth-Political-participation_Lit+review_BRIEF_FINAL.pdf), aksesuar në 20.04.2024

<sup>2</sup> Adler, Richard; Goggin, Juddy, "What do we mean by Civic Engagement", fq.7. Linku: [https://www.unomaha.edu/international-studies-and-programs/\\_files/docs/adler-goggin-civic-engagement.pdf](https://www.unomaha.edu/international-studies-and-programs/_files/docs/adler-goggin-civic-engagement.pdf), aksesuar në 10.04.2024

**Tabela I: Treguesit e angazhimit qytetar**

| Treguesit e angazhimit qytetar  | Treguesit zgjedhorë                                 | Indikatorët e zërit politik                         |
|---|---|---|
| Zgjidhja e problemeve komunitare  | Votimi i rregullt                                   | Kontaktimi i zyrtarëve                              |
| Anëtarësi aktive në një grup ose shoqatë  | Kontributet në fushatë elektorale                   | Kontaktimi i medias së shkruar                      |
| Vullnetarizëm i rregullt në një organizatë jopolitike                             | Vullnetarizmi për kandidatë ose organizata politike | Kontaktimi i medias transmetuese                    |
| Pjesëmarrja në ngritjen e fondeve përmes aktiviteteve si maratonat, çiklizmi etj. |   | Protestat   |
| Të tjera forma të ngritisës së fondeve për bamirësi                               |   | E-maile/peticione të shkruara                       |
|   |   | Bojkotimi   |
|   |   | Përpjekja për të marrë mbështetje politike ose vota |

Burimi: Keeter et al. (2002:3)<sup>3</sup>

Treguesit e angazhimit qytetar ndahen në tre kategori kryesore: *treguesit qytetarë*, duke përfshirë vullnetarizmin, mbledhjen e fondeve për kauza bamirësie etj.; *treguesit e pjesëmarrjes në procesin zgjedhor*, që përfshijnë votimin, angazhimin për një parti politike etj. dhe *indikatorët e aktivitetit politik*, që përfshijnë aktivitete në mbështetje ose në kundërshtim të kauzave ose të politikave të caktuara. Termi *angazhim politik* i referohet angazhimit të individëve në institucione, procese dhe në vendimmarrjen politike<sup>4</sup>. Tipologjia e pjesëmarrjes politike mund të jetë direkte si formë e angazhimit në zgjedhje, referendumë etj. por dhe e organizuar ose e ndërmjetësuar si anëtarësimi në një parti politike etj.

<sup>3</sup> Human Affairs, "The concept and determinants of civic engagement", fq. 257.

Linku: <https://acrobat.adobe.com/id/urn:aaid:sc:eu:875410be-cd6f-4520-9b69-b042b6e36136>, aksesuar në 10.04.2024

<sup>4</sup> Barett, Martyn. and Pachi, Dimitra, "Youth Civic and Political Engagement", fq. 3. Linku [https://library.oapen.org/bitstream/handle/20.500.12657/41406/9781848721616\\_oachapter1.pdf?sequence=1&isAllowed=y](https://library.oapen.org/bitstream/handle/20.500.12657/41406/9781848721616_oachapter1.pdf?sequence=1&isAllowed=y) aksesuar në 13.04.2024

Pjesëmarrja publike qytetare i referohet përfshirjes së qytetarëve dhe komunitetit në fazë të ndryshme të procesit politikëbërës. Tabela II paraqet një panoramë të detajuar të pjesëmarrjes qytetare të publikut nëpërmjet 5 shtyllave përbërëse: informimit, konsultimit, përfshirjes, bashkëpunimit, fuqizimit.

## Tabela II: PJESEMARRJA QYTETARE E PUBLIKUT

| INFORMOHU  | KONSULTOHU   | PËRFSHIHU  | BASHKËPUNO  | FUQIZOHU   |
|--|--|--|---|--|
| Qeveria i ofron publikut informacion objektiv në lidhje me çështjet shqetësuese dhe opionet e politikave | Qeveria merr feedback të publikut në lidhje me opionet e politikave të ndryshme dhe vendimet | Qeveria punon në mënyrë direkte me publikun, i përfshin ata nëpërmjet proceseve të bërjes së politikave dhe siguron që çështjet e tyre të dëgjohen dhe adresohen | Qeveria siguron që publiku të jetë një partner në procesin vendimmarrës dhe përfshin qytetarët dhe shoqërinë civile | Qeveria fuqizon publikun dhe fuqia e vendimmarrjes është në dorën e qytetarëve |

Burimi: United Nations, Economic and Social Commission for Western Asia<sup>5</sup>

Sipas këtij raporti, pjesëmarrja qytetare e publikut në politikëbërje mbetet e rëndësishme. Së pari, umundëson qytetarëve dhe shoqërisë civile të angazhohen në mënyrë aktive në procesin e vendimmarrjes; së dyti, kontribuon në hartimin e politikave të përshtatura sipas nevojave të shoqërisë; së treti, rrit motivimin dhe zërin e qytetarëve dhe shoqërisë civile për të përmirësuar shoqërinë dhe promovuar kapital më të madh social; së katërti, rrit vetë-efikasitetin politik të publikut dhe krijon kanale të ndryshme komunikimi që qytetarët të shprehin shqetësimet e tyre; së pesti, ul prirjen ndaj dhunës politike dhe së gjashti, fuqizon qytetarët si vendimmarrës aktivë.

Angazhimi i të rinjve në proceset demokratike mbetet një prej prioriteteve kryesore në politikat që ndjek Bashkimi Evropian. Qëllimi i politikave rimore të Këshillit të Evropës është t'u ofrojë të rinjve mundësi dhe përvojë të barabartë për të zhvilluar njojuritë, aftësitë dhe kompetencat, për të luajtur një rol

<sup>5</sup> United Nations, Economic and Social Commission for Western Asia, "Effective indicators to measure Public Civic Participation, fq.2. Linku: [https://archive.unescwa.org/sites/www.unescwa.org/files/publications/files/e\\_escwa\\_sdd\\_13\\_tp-6\\_e.pdf](https://archive.unescwa.org/sites/www.unescwa.org/files/publications/files/e_escwa_sdd_13_tp-6_e.pdf) aksesuar në 22.04.2024

të plotë në të gjitha aspektet e shoqërisë. Karta Evropiane e Rishikuar për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale është instrumenti kryesor në promovimin e menaxhimit të përbashkët, në nivel rajonal dhe lokal dhe shërben si një udhëzues pranë autoriteteve lokale dhe rajonale për zbatimin e politikave sektoriale, me përfitues si të rindjtë dhe qytetarët e tjerë<sup>6</sup>. Pjesëmarrja politike dhe angazhimi qytetar janë faktorë me rëndësi në zhvillimin e të rinjve dhe mundësi njëkohësisht për ta, për të ushtruar të drejtën e votës dhe për të rritur përgjegjësitë e tyre si qytetarë aktivë në mirëqeverisje.

---

<sup>6</sup> Council of Europe, "Manual on the Revised European Charter on the Participation of Young People in Local and Regional Life", fq.7. Linku: <https://rm.coe.int/16807023e0>, aksesuar në 24.04.2024


BASHKIA HAS

# 1. Të dhëna sociale dhe demografike të Bashkisë HAS

Ligji 114/2014 "Për ndarjen administrative në Republikën e Shqipërisë përcakton shpërndarjen e bashkive sipas qarqeve dhe funksionimin e qeverisjes vendore. Bashkia Has është pjesë e Qarkut Kukës, e cila kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Kukës dhe në lindje me Republikën e Kosovës.

Për sa i takon burimeve natyrore Hasi shtrihet në një pllajë karstike me një relief kodrinor malor, i cili i jep zonës një panoramë shumë të bukur, ku spikat mali i Pashtrikut me lartësi 1988 m mbi nivelin e detit. Gjithashtu zona është e njojur për trashëgiminë kulturore dhe biodiversitetin duke zotëruar të gjitha potencialet për zhvillimin e turizmit natyror dhe kulturor. Burimet kryesore të të ardhurave janë nga remitancat dhe prodhimi bujqësor.

**Figura I: Harta e Bashkisë Has, sipas Ministrisë së Çështjeve Vendore**



Burimi: Bashkia Has<sup>7</sup>

<sup>7</sup> Bashkia Has, "Profili Bashkisë Has", fq.1. Linku: <https://www.bashkiahhas.gov.al/wp-content/uploads/2023/06/Informacion-Statistikor-per-Bashkine-Has-.pdf> aksesuar në 05.04.2024

Sipas të dhënave të Bashkisë Has, bashkia ka një sipërfaqe prej 399.62 km<sup>2</sup> dhe përfshin 4 njësi administrative (Golaj, Krumë, Fajzë, Gjinaj)<sup>8</sup>, 31 fshatra dhe qendra e bashkisë është qyteti i Krumës.

Nga tabela III evidentohet se ka një rritje të numrit të popullsisë së Bashkisë Has nga viti 2011 në vitin 2018. Sipas Censusit të vitit 2011, Bashkia e Hasit ka një popullsi prej 16,790 banorësh, ndërkohë sipas regjistrat të Gjendjes Civile të vitit 2018, janë 21,764 banorë dhe dendësia është 23 banorë/km<sup>2</sup>. Mungojnë të dhënat zyrtare mbi numrin e popullsisë për periudhën 2018-2023, por sipas informacionit të ofruar nga Bashkia Has, popullsia ka pësuar rënje për shkak të migrimit të brendshëm dhe emigrimit. Njësia Administrative Golaj, ka numrin më të lartë të banorëve e pasuar nga Njësia Administrative Krumë.

**Tabela III. Të dhënat demografike të Bashkisë Has.**

| Njësité administrative | Numri i fshatrave | Numri i familjeve | Popullsia sipas Census 2011 | Popullsia sipas Regjistrat civil 2018 |
|------------------------|-------------------|-------------------|-----------------------------|---------------------------------------|
| Golej                  | 12                | 2,074             | 6,187                       | 8,439                                 |
| Krumë                  | 5                 | 1,758             | 6,006                       | 7,523                                 |
| Fajzë                  | 8                 | 1,048             | 3,491                       | 4,230                                 |
| Krumë                  | 6                 | 442               | 1,106                       | 1,572                                 |
| <b>Totali</b>          | <b>31</b>         | <b>5,322</b>      | <b>16,790</b>               | <b>21,764</b>                         |

Burimi: Bashkia Has<sup>9</sup>

Sipas të dhënave të Bashkisë Has, 3,379 të rinj i përkasin grupmoshës 15-20 vjeç dhe 2,800 të rinj i përkasin grupmoshës 20-29 vjeç. Në total 6,179 të rinj në Bashkinë Has i përkasin grupmoshës 15-29 vjeç dhe përbëjnë gjithsej 28% të popullsisë.

Fëmijët ose grupmosha 0-14 vjeç përbëjnë 28.7% të popullsisë, popullsia e aftë për punë (grupmosha 15-64 vjeç) është 63.8%, ndërkohë të moshuarit përbëjnë 7.5% të popullsisë. Vajzat dhe gratë përbëjnë 50.3% të popullsisë dhe 7.4% e familjeve drejtohen nga kryefamiljare femra<sup>10</sup>.

<sup>8</sup> Bashkia Has, "Profili Bashkisë Has", fq.1. Linku: <https://www.bashkiah.com.al/wp-content/uploads/2023/06/Informacion-Statistikor-per-Bashkine-Has-.pdf> aksesuar në 05.04.2024

<sup>9</sup> Po aty, fq. 3

<sup>10</sup> Bashkia Has, "Profili Bashkisë Has", fq.3. Linku: <https://www.bashkiah.com.al/wp-content/uploads/2023/06/Informacion-Statistikor-per-Bashkine-Has-.pdf> aksesuar në 05.04.2024

## 2. Buxhetimi për rininë

Bashkia Has ka një tregues të autonomisë financiare nën 20% të të ardhurave të veta ndaj totalit të të ardhurave, sipas të dhënave të Ministrisë së Financave. Të ardhurat e veta vendore ndaj totalit të të ardhurave sipas bashkive për vitin 2022 për Bashkinë Has janë 7%, ndërsa transferta e pakushtëzuar ndaj të ardhurave të veta sipas bashkive për vitin 2022 është 831%, duke shënuar kështu vlerën më të lartë të varësisë fiskale ndaj transfertave të buxhetit qendror për këtë tregues nga të 61 Bashkitë<sup>11</sup>. Gjithashtu për sa i takon të ardhurave për këtë bashki, 95% e tyre sigurohen nga taksat dhe tarifat<sup>12</sup>.

Tabela IV tregon burimet e financimit për Bashkinë Has për tre vitet buxhetore: 2021, 2022 dhe 2023. Buxheti i Bashkisë Has për vitin 2023 është 304,616.000 lekë dhe është i mbështetur në burimet e financimit, paraqitur si më poshtë:

**Tabela IV: Burimet e financimit për vitet 2021-2023      në Lekë (mijë lekë)**

|   | 2023           | 2022           | 2021           |
|---|----------------|----------------|----------------|
| Transfertë e pakushtëzuar                                       | 171,207        | 148,628        | 144,202        |
| Transfertë e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e deleguara | 98,098         | 84,799         | 80,596         |
| Të ardhura të planifikuara                                      | 35,311         | 29,126         | 24,630         |
| Transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara              |                | 2,650          |                |
| <b>Totali</b>   | <b>304,616</b> | <b>265,203</b> | <b>249,428</b> |

## Burimi: Bashkia Has

Transferta e pakushtëzuar e dërguar për vitin 2023 sipas ligjit për buxhetin e vitiit 2023 zë 56.2% të buxhetit lokal për të cilin merr vendim këshilli bashkiak. Transferta e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e deleguara për vitin 2023 sipas ligjit për buxhetin e vitiit 2023 zë 32.2% të buxhetit, ndërsa të ardhurat zënë një peshë prej 12% të buxhetit. Siç vërehet ka një rritje të buxhetit për këtë bashki për vitin 2023, në një analizë krahasuese midis tre viteve të paraqitura,

<sup>11</sup> Ministria e Financave dhe Ekonomisë, "Raporti Vjetor Financat Publike Vendore 2022", fq.101. Linku: <https://core.fvv.al/storage/reports/raporti-vjetor-2022-financat-publike-vendorepdf-1689971542.pdf>. aksesuar në 25.04.2024

<sup>12</sup> Po aty, fq. 31

reflektuar dhe në burimet e financimit si të drejtpërdrejta nga qeveria qendrore por dhe në mbledhjen e të ardhurave të planifikuara.


Më poshtë është paraqitur tabela e shpërndarjes së buxhetit, sipas programeve për vitin buxhetor 2023 në Bashkinë Has.

**Tabela V: Shpërndarja e buxhetit sipas programeve, 2023 në Lekë (mijë lekë)**

| Nr                 | Emërtimi  | Shuma              |
|--------------------|---|--------------------|
| 1                  | Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi                | 50,072,000         |
| 2                  | Sherbimet e Policisë vendore                          | 6,720,000          |
| 3                  | Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile               | 26,126,000         |
| 4                  | Shërbimet Bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore    | 4,810,000          |
| 5                  | Menaxhimi i Infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit   | 12,445,000         |
| 6                  | Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave                   | 18,426,000         |
| 7                  | Rrjeti rrugor rural                                   | 32,188,530         |
| 8                  | Menaxhimi i Mbetjeve                                  | 14,315,000         |
| 9                  | Planifikimi Urban dhe Vendor                          | 3,970,000          |
| 10                 | Shërbimet publike vendore                             | 47,944,876         |
| 11                 | Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime                       | 4,770,000          |
| 12                 | Sport dhe argëtim                                     | 2,330,000          |
| 13                 | Trashëgimi kulturore, eventet artistike dhe kulturore | 3,840,000          |
| 14                 | Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollar            | 49,590,470         |
| 15                 | Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm                         | 16,580,000         |
| 16                 | Përkujdesja Sociale                                   | 10,188,124         |
| 17                 | Strehimi Social                                       | 300,000            |
| <b>Totali Lekë</b> |   | <b>304,616,000</b> |

Burimi: Bashkia Has

**Figura II: Paraqitura e programeve në buxhet**



Burimi: Bashkia Has

Në buxhetin e vittit 2023 programi i sportit dhe argëtimit është 2,330,000 mijë lekë dhe trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore, të cilat përfshijnë edhe aktivitete rinore janë gjithsej 3,840,000 mijë lekë. Pra nga paraqitura e të dhënave më sipër mbi zërat e buxhetit, evidentohet se buxheti për rrininë i shpërndarë në aktivitete të ndryshme sportive dhe argëtuese është një buxhet i vogël. Programi i sportit dhe i argëtimit zë rrith 1% të buxhetit të bashkisë për vitin 2023.

Nga analiza e të dhënave të Bashkisë Has, buxheti i dedikuar për aktivitetet rinore për vitin 2021 ishte 2,360,550 mijë lekë, duke pësuar një rënje me 2% për këtë zë në buxhetin e vittit 2023. Gjithashtu këto të dhëna tregojnë nivelin e lartë të varësisë fiskale ndaj transfertave të buxhetit qendror, reflektuar kjo dhe në buxhetet e ulëta vjetore të Bashkisë Has për aktivitetet rinore.

Në lidhje me transparencën dhe pjesëmarrjen sipas ligjit të vetëqeverisjes vendore Nr. 139/2015, neni 16 mbi konsultimin publik, qytetarët kanë të drejtë të përfshihen në proceset konsultuese të buxhetit vjetor të bashkisë dhe të buxhetit afatmesëm. Sipas ligjit të konsultimit publik Nr. 146/2014 neni 5, është e rëndësishme transparenca gjatë procesit të njoftimit e të konsultimit publik me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese.

## **3. Gjetjet kryesore të angazhimit politik të të rinjve**

### **3.1 Analizë e angazhimit politik konvencional dhe jokonvencional**

Në Republikën e Shqipërisë në nivel kombëtar janë hartuar strategji dhe plane veprimi për përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve. Ligji Nr. 75/2019 "Për rininë" synon mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimin e funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimin me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka hartuar Strategjinë Kombëtare të Rinisë, 2022-2029, dhe Planin e Veprimit të kësaj strategje. Kjo strategji është në përputhje me Strategjinë Evropiane për Rininë 2019-2027 dhe e vë theksin ndër të tjera tek angazhimi qytetar dhe politik i të rinjve, nëpërmjet përfshirjes së tyre në çështjet komunitare dhe proceset vendimmarrëse. Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029 do të jetë dokumenti ku do të bazohen politikat për aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve. Ky dokument do të synojë hartimin e politikave rimore kombëtare integruese, për adresimin e problematikave të ndryshme me të cilat përballen sot të rintjtë e që lidhen me sfida si: përfshirja e tyre në proceset vendimmarrëse, punësimi, edukimi, teknologjia dhe inovacioni, rritja e aktivitetave në lidhje me artet dhe zejet, shtim të aktivitetave sportive, vullnetarizëm etj.<sup>13</sup>.

---

<sup>13</sup> Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2022-2024, fq. 408. Linku: [https://integrmi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/PLANI-KOM-B%C3%8BTAR-P%C3%8BR-INTEGRIMIN-EVROPIAN\\_Final.pdf](https://integrmi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/PLANI-KOM-B%C3%8BTAR-P%C3%8BR-INTEGRIMIN-EVROPIAN_Final.pdf), aksesuar në 02.05.2024

E drejta e votës është e drejtë kushtetuese që duhet t'i garantohet çdo qytetari. Kjo e drejtë buron nga Kushtetuta si akti më i lartë juridik në hierarkinë e akteve ligjore. Sipas Kushtetutës, çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet<sup>14</sup>.

Standardet kryesore ndërkombëtare mbi të drejtën për të marrë pjesë në çështjet publike bazohen në disa konventa. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (Neni 25) përcakton: "Çdo qytetar ka të drejtën dhe mundësinë për të marrë pjesë në çështjet publike, drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, të votojë dhe të zgjidhet dhe të ketë akses në shërbimet publike të vendit të vet..."<sup>15</sup>.

Sipas të dhënave të Freedom House për Shqipërinë në vitin 2024 të drejtat politike janë në raportin 28/40, ndërsa liritë qytetare në raportin 40/60 duke shënuar kështu një total prej 68 pikësh<sup>16</sup>. Shqipëria sipas këtyre të dhënave nga Global Freedom Score mban një status si pjesërisht e lirë, edhe pse ka një rritje të lehtë nga viti 2023. Ndërsa për sa i takon të dhënave bazuar në këtë burim mbi nivelin e demokracisë, Shqipëria shënon vlerën 3.79 nga 7 sipas shkallës vlerësuese të progresit demokratik të një vendi.

Aktualisht në Republikën e Shqipërisë, sipas të dhënave të popullsisë të INSTAT, janar 2024, në vitin 2023, numri i të rinxve ishte 587,888, të cilët zënë një peshë specifike prej 21% të popullsisë totale<sup>17</sup>. Në nivel kombëtar angazhimi politik i të rinxve ka rënë nga viti në vit, i cili u reflektua edhe në pjesëmarrjen e tyre në zgjedhjet lokale në 14 maj të vitit 2023. Nga 122,545 zgjedhës që votonin për herë të parë, sipas të dhënave të raportuara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vetëm 16,628 prej tyre ose 13.5% e ushtruan të drejtën e votës.

Sipas të dhënave të Bashkisë Has, pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet lokale të vitit 2019 ishte 27,53%<sup>18</sup>, ndërsa pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet lokale

<sup>14</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 45, pika 1. Linku: <https://qbz.gov.al/pre-view/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>, aksesuar në 25.04.2024

<sup>15</sup> UN Human Right Office, "International Covenant on Civil and Political Rights", Article 25. Linku: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-covenant-civil-and-political-rights> aksesuar në 29.04.2024

<sup>16</sup> Freedom House, "Freedom in the World 2024, Albania". Linku: <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2024> aksesuar në 29.04.2024

<sup>17</sup> INSTAT "Popullsia", Linku: <https://www.instat.gov.al/al/statistika/t%C3%AB-dh%C3%AB-na-ky%C3%A7e/> aksesuar në 24.04.2024

<sup>18</sup> Bashkia Has, "Buxheti për qytetarin", fq. 4.

Linku: <https://drive.google.com/file/d/152jqUawXD2GeFylwlVW6IdpJJwePIV9g/view> aksesuar në 05.04.2024

të vitit 2023 për Bashkinë Has ishte 8070 banorë ose 37% e popullsisë me të drejtë vote. Për këtë bashki është shënuar një rritje me gati 10% në numrin e përgjithshëm të votuesve në zgjedhjet lokale të vitit 2023 krahasuar me zgjedhjet e vitit 2019.

Anketimi i realizuar me të rinj të grupmoshës 18-29 vjeç, në Bashkinë Has mblodhi dhe karakteristikat socio-demografike mbi gjininë, vendbanimin dhe arsimimin e të anketuarve, respektivisht 61% vajza dhe 39% djem, 63% në zona urbane dhe 37% në zona rurale, 15% me arsim të lartë, 79% me arsim të mesém dhe 6% me arsim nëntëvjeçar.

Nga përpunimi i të dhënave, në lidhje me pjesëmarrjen politike përmes votimit, rezultoi se 59% prej tyre kanë votuar dhe 25% prej tyre nuk kanë marrë pjesë në asnjë formë të angazhimit politik konvencional.


Në përgjithësi, mosmbajtja e premtimeve elektorale nga kandidatët reflekton në interesimin e ulët të angazhimit politik, mosbesimin në programet zgjedhore dhe sesi këto programe përfshijnë çështjet mbi të rinjtë (shiko Figurën III).

Nuk janë të pakta studimet që kanë gjetur prova bindëse se të rinjtë nuk janë apatikë dhe të painteresuar ndaj politikës institucionale, por janë shumë skeptikë për shkak të mosbesimit ndaj klasës politike. Nga ana tjetër 'premtimet e thyera' (Cathcart 2015) kanë prodhuar gjithashtu dhe një "klasë" të rinjsh të informuar dhe kritikë<sup>19</sup>.

---

<sup>19</sup> European Parliament, Policy Department for Citizens' Rights and Constitutional Affairs "Young people's participation in European democratic processes", fq 66. Linku: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2023/745820/IPOL\\_STU\(2023\)745820\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2023/745820/IPOL_STU(2023)745820_EN.pdf) aksesuar në 10.04.2024

**Figura III: Forma të angazhimit politik konvencional të të rinjve**



Burimi: Center for Bridging Communities, Albania, 2024

Nëse i referohemi indeksit të pjesëmarrjes politike, sipas Economist Intelligence Unit që vlerëson masën në të cilën qytetarët mundën dhe marrin pjesë në politikë, ky indeks për Shqipërinë është 5 pikë për 2022. Për periudhën 2015-2017 vlerat kanë qenë 5.56 pikë, duke shënuar dhe periudhën me vlerën më të lartë prej 2006. Trendi i indeksit për pjesëmarrjen politike në Shqipëri prej vitit 2017 deri në vitin 2022 ka pësuar rënie<sup>20</sup>.

Nga fokus grupi me të rinj të grupmoshës 18-29 vjeç të pyetur mbi situatën politike, të rinjtë u shprehën për një situatë politike konfliktuale me dinamika të zhvillimit të paqarta. Një pjesë e të rinjve diskutoi mbi ndikimin që politika ka në jetën e tyre dhe përgjegjësinë qytetare të çdo individi, për të sjellë ndryshim në komunitet përmes ushtrimit të së drejtës së votës. Sipas perspektivës së të rinjve rezultoi sa ata kanë një interes të ulët mbi çështjet politike dhe se komuniteti ku ata jetojnë nuk është mbështetës, duke i përballur me një sërë dilemash mbi angazhimin politik.

Arsyet pse të rinjtë janë më pak të angazhuar në politikë, më pak të prirur për të marrë pjesë në aktivitete politike dhe shfaqin më pak interes politik (shih Quintelier 2007, 165) shihen nga disa studiues të lidhura me ciklin jetësor të

<sup>20</sup> Our World in Data "Political participation index" <https://ourworldindata.org/grapher/political-participation-index-eiu?tab=chart&country=~ALB> aksesuar në 12.04.2024

individit (d.m.th. fakti që sjellja politike e një personi ndryshon gjatë gjithë jetës). Teoria e efekteve të ciklit jetësor thotë se pjesëmarrja rritet nga rinia në moshën e mesme dhe më pas zvogëlohet ngadalë drejt moshës më të vjetër<sup>21</sup>. Sipas Figurës III, vetëm 8% e të rinxve të anketuar janë përfshirë në fushata zgjedhore politike për kandidatët apo partitë politike, 4% janë të anëtarësuar në një parti politike dhe po 4% kanë kandiduar në zgjedhjet elektorale lokale.

Në diskutimet në fokus grupe, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve të grupmoshës 18-29 vjeç, u përgjigjën se nuk do të donin të ishin pjesë e një partie politike ose e forumeve politike rimore, e cila sërisht evidenton interesin e ulët të të rinxve për përfshirjen në proceset e vendimmarries politike në nivel vendor.

Këto të dhëna mbi rënien e interesit të të rinxve në angazhimin politik mbështeten dhe nga studime në rrafsh kombëtar. Sondazhi Kombëtar: "Të rinxjtë dhe politikat në Shqipëri", nëpërmjet të dhënavë të paraqitura tregon se të rinxjtë e Shqipërisë janë të distancuar nga partitë politike, ku shumica dërrmuese (80%) nuk janë as të angazhuar si anëtarë në këto parti dhe as si aktivistë. Pak prej tyre, 10.8% janë anëtarë dhe vetëm 9.2% janë aktivistë të partive politike<sup>22</sup>.

Në studimin "Rinia Shqiptare 2018/2019" vërehet se 87% e të rinxve në Shqipëri nuk kanë punuar për ndonjë parti politike apo grup politik dhe 90% nuk kanë marrë pjesë në aktivitete politike online përmes rrjetave sociale, por ata marrin pjesë aktivisht në zgjedhjet elektorale dhe kanë zgjedhur procesin e votimit, si shprehje e interesit të tyre për politikën<sup>23</sup>.

Vërehet një mungesë e theksuar e besimit tek institucionet publike nga të rinxjtë në të dy nivelet e qeverisjes. Makro faktorët që ndikojnë në përfshirjen e të rinxve në jetën politike, shpesh lidhen me demografinë, socialen dhe karakteristikat ekonomike të një vendi. Niveli i zhvillimit ekonomik të një vendi, si makro faktor, ndikon në pozicionin ekonomik të individëve që jetojnë brenda

<sup>21</sup> European Parliament, Policy Department for Citizens' Rights and Constitutional Affairs "Young people's participation in European democratic processes", fq.23

Linku: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2023/745820/IPOL\\_STU\(2023\)745820\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2023/745820/IPOL_STU(2023)745820_EN.pdf) aksesuar në 10.04.2024

<sup>22</sup> Qendresa Qytetare "National Survey: Young People and Politics in Albania", fq. 9.

Linku: [https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-06/national-survey\\_youth-peo-ple-and-politics-in-albania-final.pdf](https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-06/national-survey_youth-peo-ple-and-politics-in-albania-final.pdf) aksesuar në 12.04.2024

<sup>23</sup> Tirana Post "Angazhimi i rinisë vendimtar për Shqipërinë"

Linku: <https://tiranapost.al/angazhimi-i-rinise-vendimtar-per-shqiperine> aksesuar në 12.04.2024

atij vendi dhe rrjedhimisht sasinë e kohës që ata janë në gjendje t'i kushtojnë veprimtarisë politike (Brady, Verba & Schlozman, 1995).

Në kontekste lokale me mundësi të pakta rritjeje në karrierë, për grupmoshën 18-29 vjeç shpesh interes i kryesor lidhet me sigurimin e të ardhurave dhe punës. Lëvizjet migratore në Bashkinë Has, kanë ndikuar që përfshirja e të rinjve në jetën politike dhe qytetare të jetë e ulët, duke qenë se të rinjtë e grupmoshës aktive për punë janë larguar jashtë vendit.

Figura IV paraqet format e pjesëmarrjes politike jokonvencionale të të rinjve në Bashkinë Has. Pjesëmarrja politike jokonvencionale është një veprim politik i drejtpërdrejtë, i painstitucionalizuar dhe përfshin: nënshkrimin e peticioneve, marshimet dhe demonstratat dhe bojkotimin<sup>24</sup>. Në ndryshim nga pjesëmarrja politike konvencionale që përgjithësisht është individuale, pjesëmarrja politike jokonvencionale bazohet dhe në ndërmarrje iniciativash të llojit kolektiv.


Analiza e të dhënave të grumbulluara në nivel bashkie tregoi se 52% e të rinjve nuk janë angazhuar në asnjë nga format e angazhimit politik jokonvencional, 19% të të rinjve kanë qenë pjesë e protestave, demonstratave apo marshimeve, ndërsa format si nënshkrimi i peticioneve, letrave, e-maileve janë poshtë nivelit 6%.

Nëse i referohemi indeksit të pjesëmarrjes së të rinjve në Shqipëri për vitin 2021, ky indeks është 63,4% sipas Youth Hub Western Balkans and Turkey Network of youth organizations. Indeksi llogaritet në bazë të treguesve të **pjesëmarrjes ekonomike** (i referohet shkallës së përfshirjes ose, në të kundërtën, përjashtimit të të rinjve nga tregu i punës); **sociale** (i referohet angazhimit aktiv të të rinjve në jetën e komunitetit) dhe **politike** (i referohet mundësive që kanë të rinjtë për t'u përfshirë në proceset politike)<sup>25</sup>. Po sipas të dhënave të këtij raporti për Shqipërinë, rezulton se pjesëmarrja e të rinjve nën moshën 30 vjeç në parlament, ka pësuar një rënje nga 5% në 2017 në 2% në vitin 2021.

<sup>24</sup> Bárta, Ondrej; Lavizzari, Anna "INSIGHTS – MEANINGFUL YOUTH POLITICAL PARTICIPATION IN EUROPE, Council of Europe, fq. 27 Linku: <https://edoc.coe.int/en/youth-in-europe/11008-insights-meaningful-youth-political-participation-in-europe.html> aksesuar në 04.04.2024

<sup>25</sup> Partners Albania "Youth Participation Index". Linku: <https://youthwbt.eu/youth-participation-index-2021/> aksesuar në 10.04.2024

**Figura IV: Forma të angazhimit politik jokonvencional të të rinte**



Burimi: Center for Bridging Communities, Albania, 2024

Për të marrë më tepër informacion mbi angazhimin politik jokonvencional të të rinte në Bashkinë Has, u realizua një fokus grup me disa të rintë të shkollës së mesme "Skënderbeu", Krumë. Sipas të rinte rezultoi se pjesa më e madhe e tyre nuk kanë qenë të përfshirë në forma të angazhimit politik jokonvencional. Mungesën e aktivizimit të të rinte ata e shikonin kryesisht të lidhur me problematikën e emigracionit dhe për shkak të mungesës së organizatave të shoqërisë civile në këtë bashki. Interesi për politikën dhe njohuritë politike përcaktojnë nivelet e pjesëmarrjes (Barrett & Brunton-Smith, 2014; Brunton-Smith, 2011; Zukin et al., 2006). Pjesëmarrja në jetën qytetare dhe vetë veprimi politik si pjesëmarrja në protesta kolektive shpesh perceptohet si një përvojë fuqizuese e cila rrit ndjenjën e efikasitetit të brendshëm dhe përforcon ndjenjën e identifikimit me grupin (Drury & Reicher, 2009).

Sipas raportit të "Besimit në Qeverisje", përqindja e popullsisë që ka marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo që ka nënshkruar një peticion, pësoi një rënje, nga 32.2% në 2022 në 25.2% në 2023<sup>26</sup>. Studimi për rininë në Evropën Juglindore 2018/2019, konstatoi se 86% e të rinte dhe të rejave shqiptare të intervistuara nuk kanë nënshkruar kurrë një peticion me kërkesa politike, 83% e tyre nuk kanë marrë pjesë në asnjë protestë, edhe pse pranojnë që protestat janë një formë e reagimit qytetar në një shoqëri demokratike<sup>27</sup>.

<sup>26</sup> Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) "Besimi në qeverisje, Sondazhi i Opinionit Publik 2023", fq.6. Linku: [file:///C:/Users/User/Downloads/opinion\\_poll\\_2023 - al\\_0.pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/opinion_poll_2023 - al_0.pdf) aksesuar në 19.04.2024

<sup>27</sup> Tirana Post "Angazhimi i rinise vendimtar për Shqipërinë". Linku: <https://tiranapost.al/angazhimi-i-rinise-vendimtar-per-shqiperine> akcesuar në 12.04.2024

Analiza e të dhënave krahasuese midis grupmoshave 18-29 vjeç dhe 15-17 vjeç tregoi se rreth 75% e rinxve të grupmoshës 18-29 vjeç nuk janë përfshirë më parë në forma të angazhimit politik jokonvencional, duke treguar se ka përmirësim të angazhimit politik jokonvencional për grupmoshën më të re 15-17 vjeç, sipas të dhënave të mbledhura nga pyetësorët.

Përdorimi i fajeve të rrjeteve sociale në internet për t'ju bashkuar grupeve që kanë fokus politik dhe shpërndarja e fletëpalosjeve që shprehin mbështetje për një kauzë politike zënë një peshë specifike prej 7% të të anketuarve.

Barrierat kryesore në nivel individual lidhen me perceptimet e të rinxve mbi politikën, sjelljen politike të të rinxve dhe shpesh angazhimi i tyre në politikë lidhet dhe me mundësitet që politika ofron në rritjen individuale të tyre dhe përparimin në karrierë.

Faktorët psikologjikë ndikojnë sjelljen politike të të rinxve. Për shembull, kur një i ri kontaktohet personalisht nga një parti politike gjatë një fushate elektorale, kjo mund të ndikojë në qëndrimet e tij individuale ndaj proceseve politike tradicionale (Green & Gerber, 2004; Turkie, 2010). Familja ka ndikim të konsiderueshëm tek të rinjtë, në zgjedhjet e tyre individuale mbi kandidatët politikë. Të rinjtë, prindërit e të cilëve janë të interesuar për çështje politike dhe sociale kanë nivele më të larta interes i përkohës së qeverisjes lokale, ndaj dhe vendimmarrja mbi këtë strukturë pritet të kalojë në Këshillin Bashkiak Has. Sipas ligjit Nr. 75/2019 "Për Rininë", Neni 10, pika 2, Këshilli Vendor i Rinisë kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë dhe një pjesë e anëtarëve duhet të përfaqësohen nga organizatat rimore dhe/ose për të rinjtë.

### **3.2 Besimi i të rinxve në politikëbërjen lokale**

Bashkia Has është një bashki e vogël dhe numri i punonjësve që merret me çështjet rimore është i ulët. Këshilli Vendor Rinor është duke u riorganizuar pas zgjedhjeve lokale të vitit 2023 dhe ndryshimit të drejtimit të qeverisjes lokale, ndaj dhe vendimmarrja mbi këtë strukturë pritet të kalojë në Këshillin Bashkiak Has. Sipas ligjit Nr. 75/2019 "Për Rininë", Neni 10, pika 2, Këshilli Vendor i Rinisë kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë dhe një pjesë e anëtarëve duhet të përfaqësohen nga organizatat rimore dhe/ose për të rinjtë.

Nëpërmjet realizimit të disa intervistave u analizuan nga pikëpamja cilësore se cilat janë kapacitetet dhe sfidat e Këshillit Vendor Rinor dhe një pjesë të statit të bashkisë në punën me të rinjtë, adresimin e çështjeve të angazhimit të të rinxve në nivel vendor dhe sjelljen politike të tyre.

Sipas ligjit Nr. 75/2019, KVR-ja shërben si organ këshillimor pranë kryetarit të bashkisë duke propozuar përmirësimin e politikave vendore rinore. Të dhënata e mbledhura nga anëtarët e KVR-së evidentuan mangësitë në politikat lokale pér të rintjtë në këtë bashki dhe mungesën e një plani lokal veprimi pér rininë pér tre vjeçarin në vijim.

Gjithashtu, ngritja e Këshillit Vendor Rinor, kushtëzohet dhe nga anëtarësia në këtë strukturë e organizatave jofitimprurëse që punojnë me të rintjtë, të cilat mungojnë në Bashkinë Has. KVR-ja sipas funksioneve të përcaktuara nga Ligji pér Rininë i vitit 2019, nuk vepron si një strukturë plotësisht e pavarur, ndaj ndryshimet e duhura ligjore janë të nevojshme pér të sjellë më shumë efikasitet në funksionimin dhe përbushjen e përgjegjësive.


Pér të pasur një panoramë më të plotë të nivelit të besimit të të rintve të grupmoshës 18-29 vjeç në vendimmarrjen lokale u mat perceptimi i tyre mbi këtë çështje. Përgjigjet e mbledhura nga të rintjtë e grupmoshës 18-29 vjeç mbi perceptimet e tyre mbi politikëbërjen dhe politikat rinore në nivel lokal treguan se: 87% e të rintve nuk dëshironin të ishin pjesë e strukturave në nivel vendor, 65% nuk zotëronin asnjë informacion mbi politikat rinore në nivel lokal, ndërsa 85% nuk kishin asnjë informacion mbi përfshirjen e të rintve në vendimmarrjen lokale.

Në një qasje krahasuese me të dhënata në nivel kombëtar, sipas sondazhit kombëtar: "Të rintjtë në politikë", besimi i të anketuarve tek të rintjtë e tjerë të përfshirë në politikë është i ulët, ku rrëth (60%) nuk gjejnë modele të suksesshme tek të rintjtë në politikë<sup>28</sup>. Gjithashtu sipas të dhënave të një tjetër studimi rezulton se në periudhën 2018-2022 në Shqipëri, numri i kryetarëve të bashkive të grupmoshës 18-29 vjeç, ka qenë 0 (Partners Albania, 2022:12).

Të paraqitura në Figurën V, këto të dhëna të mbledhura nga të rintjtë e anketuar tregojnë pér interes dhe transparencë të ulët të informimit mbi politikëbërjen, vendimmarrjen dhe politikat rinore në nivel lokal.

<sup>28</sup> Qendresa Qytetare "National Survey: Young People and Politics in Albania", fq. 9. Linku: [https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-06/national-survey\\_young-people-and-politics-in-albania-final.pdf](https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-06/national-survey_young-people-and-politics-in-albania-final.pdf) aksesuar në 12.04.2024

**Figura V : Interesi i të rinjve mbi politikëbërjen në nivel lokal**



Burimi: Center for Bridging Communities, Albania, 2024

Ka një përqindje të lartë të të rinjve të anketuar në këtë bashki që u shprehën se nuk do të dëshironin të ishin pjesë e strukturave vendore duke treguar nivelin e lartë të mosbesimit në politikëbërje për grupmoshën 18-29 vjeç. Në fokus grupin me këtë grupmoshë, të rintjtë ndjeheshin skeptikë mbi efektivitetin e pjesëmarrjes politike të të rinjve në nivel vendor dhe rëndësinë e propozimeve të tyre në përmirësimin e pozitës së të rinjve.

Në ndryshim nga grupmosha 18-29 vjeç, në diskutimet me fokus grupin me të rinj të grupmoshës 15-17 vjeç, u vërejt një besueshmëri më e lartë në proceset e politikëbërjes lokale. Të dhënat e mbledhura për këtë grupmoshë tregojnë interesin e shtuar të të rinjve mbi angazhimin politik jokonvencional.

Sondazhi i Gallup World Poll tregon se mesatarisht besimi në qeveritë kombëtare në Ballkanin Perëndimor është më i lartë për grupmoshat më të vjetra krahasuar me ato më të reja. Qytetarët e moshës 50 vjeç e lart priren të kenë nivelin më të lartë të besimit në qeverinë kombëtare (37%) krahasuar me ata të moshës 15-29 dhe 30-49 vjeç (31% dhe 32% respektivisht) <sup>29</sup>.

Një faktor me ndikim në përfaqësimin e të rinjve në strukturat rinore lokale dhe vendimmarrëse është mjedisi social dhe kulturor ku ata jetojnë. Shpesh në kontekste sociale të myllura ku mbizotëron fryma e konservatorizmit,

<sup>29</sup> OECD, "Government at a Glance: Western Balkans", Trust in government, Linku: [https://www.oecd-ilibrary.org/sites/a8c72f1b-en/1/3/9/1/index.html?itemId=/content/publication/a8c72f1b-en&\\_csp\\_=762150f8ebcc22b4a63f8aec03e7faf9&itemIGO=oecd&itemContentType=book](https://www.oecd-ilibrary.org/sites/a8c72f1b-en/1/3/9/1/index.html?itemId=/content/publication/a8c72f1b-en&_csp_=762150f8ebcc22b4a63f8aec03e7faf9&itemIGO=oecd&itemContentType=book) aksesuar në 18.04.2024

patriarkalitetit dhe ka shtrëngesa të ndryshme social- kulturore është e vështirë të arrihet pjesëmarrja aktive qytetare dhe politike e të rinxve.

Ne mund të diskutojmë pjesëmarrjen politike të të rinxve edhe në kontekstin e marrëdhënieve midis brezave: konflikt apo solidaritet. Në literaturë shpesh mund të vërejëmë shumë ndryshime në pjesëmarrjen politike të të rinxve dhe të rriturve; të rinxjtë paraqiten si të pa interesuar, indiferentë ndaj proceseve politike, ndërsa të rriturit paraqiten si pjesëmarrës aktivë të jetës politike (Pleyers dhe Karbach 2014)<sup>30</sup>. Në këtë proces duhen vlerësuar dhe pengesat strukturore me të cilat përballen të rinxjtë në angazhimin e tyre politik, si kufijtë e moshës për votim ose kandidim për poste<sup>31</sup>. Në vende të Bashkimit Evropian si Gjermania, Belgjika, Austria dhe Malta mosha më e ulët e votimit është 16 vjeç, ndërsa ne Greqi 17 vjeç. Në vendet e tjera të Bashkimit Evropian dhe vende evropiane përfshirë Shqipërinë, votuesit që votojnë për herë të parë janë 18 vjeç.

Nga të dhënat e mbledhura nga anketimi në Bashkinë Has, u evidentua një mungesë transparence e vendimmarrjes lokale mbi programet dhe politikat rinore në vitet e fundit, e cila ka sjellë si rezultat dhe informacion të kufizuar mbi përfshirjen e të rinxve në nisma qytetare apo angazhim politik.

Sipas raportit të fundit të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), me titull "Besimi në qeverisje" për vitin 2023, përqindja e shqiptarëve të interesuar për të marrë pjesë në vendimmarrje ka qëndruar pothuajse e njëjtë (43.2%) në krahasim me vitin 2022 (45.3%). Një përqindje e vogël e qytetarëve të anketuar raportojnë se kanë pasur mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen qendrore (27.3%), ndërkohë që një përqindje paksa më e madhe i konsideronin mundësitë më të përshtatshme për pjesëmarrje në vendimmarrjen vendore (36.9%) dhe të dy nivelet mbeten pothuajse të qëndrueshme në krahasim me vitin 2022<sup>32</sup>.

Pjesëmarrja aktive e të rinxve, kur është gjithëpërfshirëse dhe kryhet në bashkëpunim me vendimmarrësit, mund të ndikojë në rezultatet e politikave

<sup>30</sup> Galstyan, Marina "Youth Political Participation", fq. 11 [https://pjp-eu.coe.int/documents/42128013/47262631>Youth-Political-participation\\_Lit+review\\_BRIEF\\_FINAL.pdf/1ff0bb91-a77b-f52e-25b4-5c8bd45a0c36](https://pjp-eu.coe.int/documents/42128013/47262631>Youth-Political-participation_Lit+review_BRIEF_FINAL.pdf/1ff0bb91-a77b-f52e-25b4-5c8bd45a0c36), aksesuar në 20.04.2024

<sup>31</sup> Bárta, Ondrej; Lavizzari, Anna "INSIGHTS – MEANINGFUL YOUTH POLITICAL PARTICIPATION IN EUROPE, Council of Europe, fq. 20 Linku: <https://edoc.coe.int/en/youth-in-europe/11008-insights-meaningful-youth-political-participation-in-europe.html> aksesuar në 04.04.2024

<sup>32</sup> Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, IDM "Besimi në qeverisje, Sondazhi i Opinionit Publik 2023, fq. 6. Linku: <https://www.undp.org/albania/publications/trust-governance-opinion-poll-2023> aksesuar në 20.04.2024

dhe të frenojë tokenizmin politik, ndaj është e rëndësishme të promovohen modele konsultative të pjesëmarrjes së të rinjve.

*Pjesëmarrja e të rinjve në proceset politike dhe vendimmarrëse si votimi, anëtarësimi në një parti politike, kandidimi për zgjedhje politike, përfshirja në fushata zgjedhore është e ulët.*

*Rreth 80% e të rinjve të grupmoshës 15-29 vjeç në Bashkinë Has u përgjigjën se nuk do të donin të ishin pjesë e një partie politike ose e forumeve politike rimore dhe 87% e të rinjve të grupmoshës 18-29 vjeç u përgjigjën se nuk do të donin të ishin pjesë e strukturave në nivel vendor.*

*Nivele shumë të ulëta të angazhimit politik jokonvencional u gjetën për të rinjtë e grupmoshës 15 -29 vjeç ku rreth 52% e të anketuarve nuk ishin angazhuar në asnjë formë të angazhimit politik jokonvencional si protesta, demonstrata, marshime, nënshkrim i petacioneve, shkrimi i letrave, e-maileve për politikanë ose zyrtarë të lartë etj.*

# Rekomandime


- 1) Rritja e ndërgjegjësimit të të rinxve mbi të drejtën e votës përmes programeve të lidershipit, edukimit ligjor, edukimit në vazhdim, fushatave ndërgjegjësuese. Të rinxjtë kanë besim të ulët në politikëbërje, ndaj edukimi politik i tyre është një mjet i rëndësishëm në të mësuarit mbi demokracinë si sistem politik dhe proceset e vendimmarrjes.
- 2) Promovimi i një mjedisi mundësues që përfshin kuadrin ligjor, politikat rimore dhe planet e veprimit përrininë, karëndësi përtësiguruar pjesëmarrjen e të rinxve në një gamë të gjerë procesesh zgjedhore dhe në qeverisjen lokale. Kjo kërkon përmirësimë dhe rishikime të kuadrit ligjor në funksion të nxitjes së angazhimit politik të të rinxve.
- 3) Forcimi i besimit të vendimmarrësve lokalë mbi rolin thelbësor të të rinxve në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit.
  - ✓ Propozimi i të rinxve si kandidatë për pozicione të rëndësishme në qeverisjen vendore. Pjesëmarrja politike shërben si një mekanizëm i rëndësishëm përfshirjen e zhvillimin e të rinxve. Duke u angazhuar në vendimmarrje, të rinxjtë mësojnë jo vetëm për proceset politike por gjithashtu zhvillojnë aftësi si vetëvlerësimi, besimi, aftësitë negociuese dhe të lidershipit.
  - ✓ Përmirësimi i përfaqësimit të të rinxve në qeverisjen vendore, duke i vendosur në pozicione "të favorshme" në listën për zgjedhjet e këshillave bashkiake.
- 4) Ngritje të kapaciteteve profesionale të punonjësve të bashkisë që punojnë drejtpërdrejtë me të rinxjtë dhe politikat rimore. Punonjësit përtë rinxjtë luajnë një rol të rëndësishëm, duke përcjellë informacione rreth proceseve politike të të rinxve dhe gjithashtu duke informuar politikëbërësit mbi nevojat e të rinxve.
- 5) Rritja e transparencës dhe e informimit mbi iniciativat lokale, programet rimore dhe buxhetet e dedikuara përrininë. Kryerja e studimeve dhe e raporteve vlerësuese mbi pjesëmarrjen, përfaqësimin dhe përfshirjen e të rinxve do të përmirësonë transparencën dhe do të siguronte një bazë të dhënash për organizatat advokuese, përtë përfaqësuar me kompetencë interesat rimore.

## 4. Gjetjet kryesore të angazhimit qytetar të të rinjve

### 4.1 Problematikat dhe sfidat lokale

Të rinjtë përballen me sfida të shumta, të lidhura si me problematika lokale por dhe me problematika të drejtpërdrejta. Nga shqyrtimi i të dhënave të pyetësorëve, problematika kryesore komunitare në Bashkinë Has sipas perceptimit të të rinjve është shërbimi shëndetësor. Rreth 67% e të anketuarve theksuan se mungesa e qendrave shëndetësore, veçanërisht në zonat rurale; personelit shëndetësor të specializuar dhe e medikamenteve janë problematika që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme. Problematikë tjetër e evidentuar nga të rinjtë është emigrimi i forcës aktive të punës, me një peshë specifike gjithsej 66% të të anketuarve. Sipas informacionit plotësues të marrë nga Bashkia Has, ka 1200 të rinj të cilët janë larguar në vitet 2021-2023 dhe viti 2022 shënon dhe vitin me emigrimin më masiv kryesisht drejt Britanisë së Madhe.

**Figura VI: Problemata komunitare në Bashkinë Has**



Burimi: Center for Bridging Communities, Albania, 2024

Në nivel kombëtar, duke ju referuar shkallës së papunësisë së të rinxve, sipas Anketës Tremujore të Forcave të Punës 2024, evidentohet se shkalla e papunësisë së të rinxve është rritur nga viti 2021 në vitin 2023, me 2%. Kjo është një e dhënë që tregon se një pjesë e konsiderueshme e të rinxve nuk është integruar në tregun e punës.

Ka përpjekje nga qeveria qendrore dhe lokale për të mbështetur të rinjtë siç është programi i Garancisë Rinore. Ky program synon integrimin e rinxve në tregun e punës dhe po pilotohet në tre bashki të vendit: Tiranë, Shkodër dhe Vlorë. Zbatimi i Skemës së Garancisë Rinore parashikon që të rinjtë e papunë të regjistruar në zyrat e punës brenda një periudhe të caktuar duhet të marrin një ofertë punësimi, trajnimi apo mësimi profesioni.

Në Bashkinë Has, papunësia si problematikë e të rinxve është evidentuar nga 45% e të anketuarve. Në nivel lokal nuk ka të dhëna zyrtare mbi nivelin e papunësisë së të rinxve. Sipas të dhënave në nivel bashkie janë gjithsej 84 individë të grumoshës 22-29 vjeç të regjistruar si punëkërkues për vitin 2023, por kjo shifër është më e lartë duke konsideruar numrin e të rinxve që nuk regjistrohen si punëkërkues. Një përcaktim i qartë i programeve për nxitjen e punësimit nëpërmjet zyrës së punës do të ndihmonte të rinjtë të integroheshin në treg. Zhvillimi i programeve dhe trajnimeve për të rinjtë, do të kërkonte rritje të buxheteve lokale për iniciativa rimore dhe mbështetjen nga aktorët lokalë si biznese etj.

Nga analiza e figurës VI del qartë se edhe dukuria e bullizmit është e pranishme, në masën 38% sipas raportimeve të të rinxve dhe kjo kryesisht për të rinjtë e zonave rurale të grumoshës 15-17 vjeç.

Në studimin e realizuar nga UNICEF "Raportimi i Dhunës ndaj Fëmijëve në Shqipëri", në 12 qarqet në Republikën e Shqipërisë rezultoi se: "60 përqind besojnë se bullizmi kibernetik është shumë i përhapur dhe 57 përqind besojnë se bullizmi në shkolla është shumë i zakonshëm"<sup>33</sup>.

Problematika të tjera komunitare rezultuan: infrastruktura e dobët dhe transporti veçanërisht për zonat e largëta në masën 19%, vështirësitet e aksesit në edukim 15%, shërbimet sociale 15%, turizmi 13%, cilësia e jetës 9%, ndërsa të gjithë

<sup>33</sup> UNICEF Shqipëri "Raportimi i Dhunës ndaj Fëmijëve në Shqipëri", Rezultatet e anketës kombëtare për njohuritë, qëndrimet dhe praktikat, fq.28.

Linku: <https://www.unicef.org/albania/media/6606/file/Raportimi%20i%20Dhun%C3%ABs%20Ndaj%20F%C3%ABmij%C3%ABve%20n%C3%AB%20Shqip%C3%ABri.pdf> aksesuar në 22.04.2024.

treguesit e tjerë janë poshtë nivelit 8%. Mungesa e infrastrukturës ka sjellë si rezultat një zhvillim të kufizuar të sektorit të turizmit, ku më tepër mbizotëron turizmi ditor i lidhur me pozitën gjeografike të Hasit.

Nivelet e larta të papunësisë dhe të emigrimit të të rinjve u evidentuan si sfidat kryesore nga fokus grupei organizuar me grupmoshën 18-29 vjeç. Një tjetër problematikë e evidentuar nga diskutimet me të rinjtë ishte dhe moskthimi i të rinjve të arsimuar si brenda vendit dhe jashtë vendit, duke humbur një kapital njerëzor të çmuar me ndikim në zhvillimin e qëndrueshëm dhe endogjen të komunitetit.


Problematikat kryesore komunitare të të rinjve të evidentuara në Bashkinë Has janë: *Shërbimi Shëndetësor 67%, Emigrimi 66%, Infrastruktura dhe urbanistika 19%*.

Problematikat kryesore të lidhura drejtpërdrejt me të rinjtë në Bashkinë Has janë: *Papunësia 45%; Bullizmi 38%; Aksesi në edukim 15%*.

## 4.2 Analizë e angazhimit qytetar

Angazhimi qytetar i të rinjve është paraqitur në figurën VII dhe sipas të dhënave të paraqitura pjesa më e madhe e të rinjve gjithsej 24% janë përfshirë në veprimtari komunitare, në aktivitete si pjesë e shërbimit komunitar të bazuar në shkollë, ndërsa ndërmarrja e punës së organizuar vullnetare është raportuar nga vetëm 9%. Sipas Ligjit Nr. 139/2015 për Vetëqeverisjen vendore, Kreu XII, funksionimi i strukturave komunitare në bashki, në qytete, në bazë të iniciativës qytetare, ngrihen dhe funksionojnë këshillat komunitarë të lagjeve. Këshillat përbëhen nga banorë të lagjes dhe organizohen mbi baza vullnetare dhe mund të shërbejnë edhe për nxitjen e angazhimit vullnetar të të rinjve në nisma të ndryshme komunitare.

**Figura VII: Forma të angazhimit qytetar të të rinjve**



Burimi: Center for Bridging Communities, 2024

Aktivizimi i ulët i të rinjve lidhet ngushtësisht me dukurinë e emigracionit, që rezultoi si një ndër problematikat kryesore në nivel komunitar, që reflektohet edhe në Figurën VII. Nga të dhënat e paraqitura rezulton se nuk janë përfshirë në asnjë formë të angazhimit qytetar rreth 5% e të rinjve të anketuar. Gjithashtu aktivizimi i pakët rinoz lidhet edhe me mungesën e një organizate rimore ose për të rinjtë e cila do të nxiste aktivizmin ronor dhe gjithëpërfshirjen.

Nga përgjigjet e të anketuarve, pjesa më e madhe e të rinjve ishin angazhuan në aktivitete jashtëshkollore, në kuadër të shërbimit komunitar të bazuar në shkollë. Të rinjtë kanë realizuar disa nisma si fushata ndërgjegjësuese përmjedisin, nisma kundër bullizmit, ndihma ndaj njerëzve në nevojë etj.

Sipas Figurës VII, ndihma për mirëqenien e të tjerëve në komunitet është zgjedhur nga 19% e të anketuarve, donacione për bamirësi 19%, anëtarësimi në organizata me bazë komunitare është përzgjedhur nga 9% dhe nisma për ngritjen e fondeve të ndryshme është 7%.

Paraqitja e të dhënavëve të mësipërme tregon që ka kohezion social ku iniciativat individuale dhe kolektive për zgjidhjen e problematikave komunitare mbizotërojnë. Aktivizmi ronor dhe vullnetarizmi janë mundësi reale rritjeje për të rinjtë. Shpesh të rinjtë idealizojnë rolin e politikës në përmirësimin e drejtpërdrejtë të jetës së tyre, por jo dhe aq rolin e komuniteteve lokale si promotorë të ndryshimit.

Sipas raportit të IDM-së, treguesi i gatishmërisë së qytetarëve shqiptarë të anketuar për t'u angazhuar në punë vullnetare në komunitet në rrafsh kombëtar ka pësuar një rënie të lehtë në 2023 me 58.6% nga 61.5% në 2022<sup>34</sup>.

Të rindjtë kanë nevojë të zhvillojnë kapacitetet e tyre për të qenë qytetarë aktivë, për t'u përfshirë në çështje komunitare, në krijimin e fushatave dhe kauzave sociale, ndaj është i nevojshëm fuqizimi i të rinjve që kanë interes për të marrë pjesë në iniciativa në dobi të komunitetit. Shkëmbimi i eksperiencave kryesisht për projektet e suksesshme si praktikat e mira të qeverisjes lokale veçanërisht të vendeve të rajonit të Ballkanit me kontekste të ngjashme demografike, shoqërore dhe ekonomike është një mundësi e mirë për zhvillim.

Në përbushje të ligjit Nr. 75/2019 "Për Rininë" dhe ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Këshilli Vendor Rinor si pjesë të punës duhet të mbledhë sugjerimet e të rinjve në mënyrë periodike, nëpërmjet pyetësorëve, fokus grupeve, intervistave apo takimeve me të rinj në Njësitë Administrative ku ata mund të kenë mundësi të paraqesin idetë e tyre me kostot financiare përkatëse. Vlerësimi i nivelit të përfshirjes komunitare dhe fuqizimit të të rinjve në programet për të rindjtë mund të bëhet duke përdorur instrumente matëse, siç është për shembull pyetësori mbi vlerësimin e pjesëmarrjes dhe angazhimit të të rinjve<sup>35</sup>.

Nga studime të ndryshme të ndërmarra vitet e fundit, rezulton një transparencë e ulët mbi proceset e konsultimit në nivel kombëtar dhe vendor. Ka mungesë transparence dhe më shumë se gjysma e shqiptarëve të anketuar (59% për qeverinë qendrore dhe 60.2% për qeverisjen vendore) mendojnë se kjo evidentohet në të dy nivelet e qeverisjes. Në vitin 2023, 10.9% e shqiptarëve të anketuar ishin ftuar të angazhoheshin në proceset e konsultimit të qeverisë qendrore, ndërsa një përqindje më e lartë, 18.5%, kishin marrë ftesa për konsultime në nivel vendor. Pavarësisht luhatjeve në përqindjet e ftesave, pjesëmarrja aktuale ka mbetur vazhdimesht e ulët gjatë viteve, përgjithësisht nën 25%<sup>36</sup>.

<sup>34</sup> Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) "Besimi në qeverisje, Sondazhi i Opinionit Publik 2023", fq.6. Linku: <file:///C:/Users/user/Downloads/Opinion-Poll-2023-AL.pdf> aksesuar në 19.04.2024

<sup>35</sup> Center for Bridging Communities, "Udhëzues për Këshillin Vendor Shijak", fq. 40-49 Linku: <https://www.cbc.org.al/blog/the-guide-for-the-local-youth-council-shijak>, aksesuar në 10.04.2024

<sup>36</sup> Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) "Besimi në qeverisje, Sondazhi i Opinionit Publik 2023", fq.6. Linku: <file:///C:/Users/user/Downloads/Opinion-Poll-2023-AL.pdf> aksesuar në 19.04.2024

Analiza e problematikave dhe sfidave të pjesëmarrjes qytetare në fokus grupe, evidentoi disa bariera individuale dhe shoqërore. Barrierat kryesore në nivel individual për të rinjtë e grupmoshës 15-29 vjeç, në Bashkinë Has janë: mungesa e ndërgjegjësimit mbi të drejtat; perceptimet e të rinjve se institucionet janë njohës jo të mirë të problematikave që hasin të rinjtë; pengesat gjeografike përkthyer në nivele të ulëta të aktivizmit qytetar të të rinjve nga zonat rurale dhe mungesë e kompetencave dhe aftësive të buta. Shpesh barrierat individuale përcaktohen nga barrierat kulturore, të lidhura me nivelin e edukimit dhe me stereotipe të ndryshme që ndikojnë në angazhimin qytetar.

Të rinjtë janë përfituesit kryesorë nga pjesëmarrja aktive në proceset vendimmarrëse në nivel vendor, ndaj angazhimi dhe aktivizmi i hershëm i tyre është një hap i sigurt drejt pjesëmarrjes qytetare dhe politike. Pjesëmarrja aktive e të rinjve në proceset vendimmarrëse lokale është katalizatori kryesor për një zhvillim të qëndrueshëm dhe endogen të komunitetit.

Treguesit e angazhimit qytetar mbi përfshirjen në iniciativa në komunitet si pjesë e shërbimit komunitar të bazuar në shkollë tërhoqën përgjigjen e 24% të të rinjve, ndërsa 5% e tyre nuk janë përfshirë në asnjë formë të angazhimit qytetar. Ndihma përmirëqenien e të tjerëve në komunitet është zgjedhur nga 19% e të anketuarve, duke treguar për nivele të larta të kohezionit social si në iniciativat individuale dhe kolektive të të rinjve.

# Rekomandime

- 1) Aktivizimi i KVR-së, hartimi i planit lokal të veprimit për rininë dhe buxhetimi i tij. Këshilli Vendor Rinor duhet të kryejë vlerësimë periodike mbi nevojat, sfidat dhe pjesëmarrjen qytetare të të rinjve në këtë bashki.
- 2) Krijimi i organizatave rimore ose për të rinjtë dhe grupeve informale rimore për të fuqizuar të rinjtë si qytetarë proaktivë, për të adresuar problematikat kryesore të të rinjve, për të përfshirë të rinjtë nga grupet e margjinalizuara dhe për të advokuar në Këshillin Bashkiak Has.
- 3) Zhvillimi i programeve në funksion të forcimit të kompetencave të mësuesve, punonjësve socialë, psikologëve dhe edukatorëve të tjerë në fushën e edukimit qytetar të të rinjve. Shkollat lipset të promovojnë dhe mund të kontribuojnë në një kulturë demokratike duke krijuar një mjedis mundësues për edukimin qytetar të nxënësve.
- 4) Përdorimi i mjeteve të demokracisë digitale në funksion të zhvillimit të programeve që nxitin pjesëmarrjen qytetare të të rinjve. Platformat interaktive në mediat sociale të drejtuara nga të rinjtë mund të shërbejnë si mbështetje, për fushata informimi dhe edukimi qytetar dhe për debate mbi çështje që ndikojnë jetën e tyre, duke ofruar akses në informacion për shumë të rinj nga grupe te margjinalizuara.
- 5) Rritja e transparencës mbi programet rimore dhe përmirësimi i procedurave të konsultimit mbi çështjet e rinisë. Autoritetet lokale duhet të krijojnë një sistem efektiv të bashkëpunimit me të rinjtë për çështjet që lidhen me ta, që shkon përtej procedurave tradicionale të konsultimit.

## Përfundime

Gjetjet e paraqitura në këtë raport vlerësimi tregojnë për interesin e ulët të të rinjve mbi proceset e vendimmarrjes politike në nivel vendor dhe nivelin e lartë të mosbesimit në politikëbërje në përgjithësi.

Programi i sportit dhe i argëtimit në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2023 ka pësuar rënje krahasuar me vitet paraardhëse. Të rindjtë, duke u mbështetur nga Këshilli Vendor Rinor, lipset të marrin pjesë dhe të përfshihen rregullisht në fazat e hershme të procesit të planifikimit të buxhetit për rininë. Promovimi i modeleve konsultative të pjesëmarrjes së të rinjve në diskutimet publike përpara vendimmarrjes do të përmirësonte legjitimitetin e vendimeve politike. Ka rëndësi themelore për rritjen e aktivizmit rinor dhe pjesëmarrjen politike dhe qytetare të të rinjve aktivizimi i Këshillit Vendor Rinor, hartimi i planit lokal vendor të veprimit për rininë dhe buxhetimi i tij.

Në nivel bashkie ka një sërë barrierash strukturore të evidentuara nga anketimi me të rindjtë, ndaj është i nevojshëm të kryhet identifikimi i burimeve njerëzore dhe financiare në funksion të realizimit të programeve për të rindjtë dhe projekteve komunitare; evidentimi i problematikave të bashkëpunimit në marrëdhëniet mes aktorëve të ndryshëm në Bashkinë Has; vlerësimi i bazës ligjore ekzistuese dhe interpretimi i udhëzimeve ligjore.

Integrimi i të rinjve në tregun e punës kërkon identifikimin dhe vlerësimin e të gjitha burimeve lokale dhe hartimin e programeve për rininë. Këto programe mund të hartohen si iniciativa të përbashkëta të bashkisë me sektorin privat në një qasje zhvilluese holistique, duke konsideruar fushat e turizmit, trashëgimisë kulturore dhe biodiversitetin e zonës.

Të rindjtë në këtë bashki përballen me bariera social-kulturore, të lidhura me nivelin e edukimit dhe me stereotipe të ndryshme mbi rolin dhe ndikimin

e angazhimit politik dhe qytetar. Përmirësimi i pozicionimit të të rinxve në përfaqësim në nivel vendor kërkon zhvillimin e kapaciteteve të tyre përmes programeve të ndryshme si: programe të liderisëpit, edukimit ligjor, edukimit në vazhdim dhe projekteve të bashkëpunimit. Gjithashtu ka rëndësi ngritja e kapaciteteve të grupeve informale rinore përmes shkëmbimit të praktikave të mira dhe rrjetëzimit. Ngritja e një organizate rinore ose për të rinxjtë do të shërbente si një katalizator për aktivizmin e hershëm të të rinxve si dhe në mbështetjen e iniciativave rinore lokale.

# Bibliografia

1. Adler, R. and Goggin, J. (2005). "What do we mean by Civic Engagement", Volumi 3 [https://www.unomaha.edu/international-studies-and-programs/\\_files/docs/adler-goggin-civic-engagement.pdf](https://www.unomaha.edu/international-studies-and-programs/_files/docs/adler-goggin-civic-engagement.pdf)
2. Bárta O. and Lavizzari A. (2021). "INSIGHTS – MEANINGFUL YOUTH POLITICAL PARTICIPATION IN EUROPE", Council of Europe and European Commission <https://edoc.coe.int/en/youth-in-europe/11008-insights-meaningful-youth-political-participation-in-europe.html>
3. Barett, M. and Pachi, D. (2019) "Youth Civic and Political Engagement" [https://library.oopen.org/bitstream/handle/20.500.12657/41406/9781848721616\\_oachapter1.pdf?sequence=1&isAllowed=y](https://library.oopen.org/bitstream/handle/20.500.12657/41406/9781848721616_oachapter1.pdf?sequence=1&isAllowed=y)
4. Bashkia Has (2021). "Buxheti për qytetarin" <https://drive.google.com/file/d/152jqUawXD2GeFylwIVW6IdpJJwePIV9g/view>
5. Bashkia Has (2023). "Profili Bashkisë Has" <https://www.bashkiah.gov.al/wp-content/uploads/2023/06/Informacion-Statistikor-per-Bashkine-Has-.pdf>
6. Center for Bridging Communities (2023). "Udhëzues për Këshillin Vendor Shijak" <https://www.cbc.org.al/wp-content/uploads/2024/06/udhezues-ok.pdf>
7. Council of Europe (2015). "Manual on the Revised European Charter on the Participation of Young People in Local and Regional Life", Printed at the Council of Europe <https://rm.coe.int/16807023e0>
8. European Parliament, Policy Department for Citizens' Rights and Constitutional Affairs (2023). "Young people's participation in European democratic processes" [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2023/745820/IPOL\\_STU\(2023\)745820\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2023/745820/IPOL_STU(2023)745820_EN.pdf)

9. Freedom House (2024). "Freedom in the World 2024, Albania", <https://freedom-house.org/country/albania/freedom-world/2024>
10. Galstyan, M. (2019). "Youth Political Participation", [https://pjp-eu.coe.int/documents/42128013/47262631>Youth-Political-participation\\_Lit+review\\_BRIEF\\_FINAL.pdf/1ff0bb91-a77b-f52e-25b4-5c8bd45a0c36](https://pjp-eu.coe.int/documents/42128013/47262631>Youth-Political-participation_Lit+review_BRIEF_FINAL.pdf/1ff0bb91-a77b-f52e-25b4-5c8bd45a0c36)
11. Qendresa Qytetare (2019). "National Survey: Young People and Politics in Albania"  
Linku:[https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-06/national-survey\\_youth-people-and-politics-in-albania-final.pdf](https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-06/national-survey_youth-people-and-politics-in-albania-final.pdf)
12. Human Affairs (2017). "The concept and determinants of civic engagement"  
<https://acrobat.adobe.com/id/um:aaid:sc:eu:875410be-cd6f-4520-9b69-b042b6e36136>
13. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, IDM (2023). "Besimi në qeverisje, Sondazhi i Opinionit Publik 2023", [file:///C:/Users/User/Downloads/opinion\\_poll\\_2023\\_-\\_al\\_0.pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/opinion_poll_2023_-_al_0.pdf)
14. INSTAT (2023). "Popullsia", <https://www.instat.gov.al/al/statistika/t%C3%AB-dh%C3%ABna-ky%C3%A7e/>
15. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, <https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>
16. Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023). "Raporti Vjetor Financat Publike Vendore 2022", fq.101, <https://core.fvv.al/storage/reports/raporti-vjetor-2022-financat-publike-vendorepdf-1689971542.pdf>
17. OECD "Government at a Glance: Western Balkans", Trust in government, [https://www.oecd-ilibrary.org/sites/a8c72f1b-en/1/3/9/1/index.html?itemId=%2Fcontent%2Fpublication%2Fa8c72f1b-en&\\_csp\\_=762150f8ebcc22b4a63f8aec03e7faf9&itemIGO=oecd&itemContentType=book&fbclid=IwY2xjawEfAaZleHRuA2FlbQIxMAABHS3tCpGY-B2jUBtOZlb4FE4J6p-i4cqW8X8NDrD-WuY\\_PpF8237yx4ZEBA\\_aem\\_aGFMgUumgbSaSxhZw-bR8w](https://www.oecd-ilibrary.org/sites/a8c72f1b-en/1/3/9/1/index.html?itemId=%2Fcontent%2Fpublication%2Fa8c72f1b-en&_csp_=762150f8ebcc22b4a63f8aec03e7faf9&itemIGO=oecd&itemContentType=book&fbclid=IwY2xjawEfAaZleHRuA2FlbQIxMAABHS3tCpGY-B2jUBtOZlb4FE4J6p-i4cqW8X8NDrD-WuY_PpF8237yx4ZEBA_aem_aGFMgUumgbSaSxhZw-bR8w)
18. Our World in Data "Political participation index" <https://ourworldindata.org/grapher/political-participation-index-eiu?tab=chart&country=~ALB>
19. Partners Albania (2021). "Youth Participation Index", <https://youthwbt.eu/youth-participation-index-2021/>

20. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2022-2024. [https://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/PLANI-KOMB%C3%8BTAR-P%C3%8BR-INTEGRIMIN-EVROPIAN\\_Final.pdf](https://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2022/02/PLANI-KOMB%C3%8BTAR-P%C3%8BR-INTEGRIMIN-EVROPIAN_Final.pdf)
21. Tirana Post "Angazhimi i rinisë vendimtar për Shqipërinë", 03.08.2019 <https://tiranapost.al/angazhimi-i-rinise-vendimtar-per-shqiperine>
22. UN Human Right Office (OHCHR), "International Covenant on Civil and Political Rights" <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-covenant-civil-and-political-rights>
23. UNICEF Shqipëri (2023). "Raportimi i Dhunës ndaj Fëmijëve në Shqipëri", Rezultatet e anketës kombëtare për njohuritë, qëndrimet dhe praktikat <https://www.unicef.org/albania/media/6606/file/Raportimi%20i%20Dhun%C3%ABs%20Ndaj%20F%C3%ABmij%C3%ABve%20n%C3%AB%20Shqip%C3%ABri.pdf>
24. United Nations (2013). "Effective indicators to measure Public Civic Participation", Economic and Social Commission for Western Asia [https://archive.unescwa.org/sites/www.unescwa.org/files/publications/files/e\\_escwa\\_sdd\\_13\\_tp-6\\_e.pdf](https://archive.unescwa.org/sites/www.unescwa.org/files/publications/files/e_escwa_sdd_13_tp-6_e.pdf)
25. United Nations Youth Strategy, "Youth 2030", working with and for young people", [https://easterncaribbean.un.org/sites/default/files/2021-03/18-00080\\_UN-Youth-Strategy\\_Web.pdf](https://easterncaribbean.un.org/sites/default/files/2021-03/18-00080_UN-Youth-Strategy_Web.pdf)
26. Youth Power 2 "Toolit for Youth Inclusion in Democracy, Human Rights, and Governance", Roger Hart's Ladder of Participation, <https://www.youthpower.org/youth-drg-toolkit-3-models-roger-hart-ladder>



Center for Bridging Communities

## CENTER FOR BRIDGING COMMUNITIES

Rr. "Shefqet Ndoqi", Tirana, 1001, Shqipëri

e-mail: [info@cbc.org.al](mailto:info@cbc.org.al)

[www.cbc.org.al](http://www.cbc.org.al)